

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHËRBIMIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHËTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME, PAS NDËRPRERJES SË MARRËDHËNIEVE TË PUNËS”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për trajtimin financiar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës” ka për qëllim t’i garantojë punonjësve të këtyre institucioneve trajtim financiar në rastet e shkëputjes së marrëdhënieve të punës, përpara daljes në pension të plotë pleqërie.

Konkretisht, projektligji synon që t’i japë mundësi punonjësve të Policisë së Shtetit, punonjësve të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, që kanë një karrierë të gjatë në këto struktura, të përfitojnë trajtim financiar në rast se ata dëshirojnë të ndërpresin shërbimin ose nëse titullarët e institucioneve përkatëse kërkojnë që të ndërpresin marrëdhënien e punës përpara plotësimit të moshës për pension të plotë pleqërie. Në vlerësimin e kërkesës për të ndërprerë shërbimin merret në konsideratë edhe pamundësia fizike e punonjësit për të vazhduar karrierën e mëtejshme.

Gjithashtu, propozimet e këtij projektligji synojnë uljen e moshës mesatare të punonjësve të institucioneve të sipërpërmendura, duke siguruar që në këto institucione të rëndësishme të sigurisë të krijohet mundësia e punësimit të gjeneratës së re, në moshë më aktive dhe efçente në luftën kundër krimit në përgjithësi e atij të organizuar në veçanti, si dhe rritjen e parametrevave të rendit e sigurisë publike në vend.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN

ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është pjesë e reformës në strukturat e sigurisë, gjë e cila është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, pasi prioriteti i qeverisë për vitet në vazhdim është rritja e parametrave të rendit e sigurisë publike, forcimi i mëtejshëm i luftës kundër krimit në përgjithësi e atij të organizuar në veçanti, si dhe luftës kundër terrorizmit.

Reforma e plotë e marrë nga qeveria në këto struktura do të realizohet nëpërmjet miratimit të të gjitha akteve nënligjore në zbatim të ligjit organik, “Për Policinë e Shtetit”, si dhe rishikimit të ligjit organik të Gardës së Republikës dhe SHÇBA-së.

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën dhe është në harmoni me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore”, të ndryshuar.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektligji është i domosdoshëm për faktin se detyrat institucionale që ligji i ngarkon kryesisht Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme janë të një rrezikshmërie e vështirësie shumë të lartë në raport me detyrat institucionale që kanë strukturat tjera shtetërore.

Kështu mjafton të përmenden që vetëm në Policinë e Shtetit:

- nga viti 1991 dhe në vazhdim kanë humbur jetën në krye të detyrës 223 punonjës policie dhe janë plagosur 248;
- gjatë këtyre viteve ka dhe punonjës të Policisë së Shtetit apo të Gardës së Republikës, të vrarë apo të plagosur pas ndërprerjes së karrierës nga elementë kriminalë, që janë vetëvrarë apo kanë pësuar trauma të rënda psikike/psikologjike për shkak të kryerjes së detyrave të vështira dhe specifike, duke sjellë paaftësinë e tyre për punë në një moshë relativisht të re;
- punonjësi i Policisë së Shtetit, Gardës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, për vetë natyrën e punës në këto struktura, e kanë të limituar periudhën e ushtrimit të detyrave, të cilat kërkojnë aftësi të larta fizike dhe rrjedhimisht do të largohen nga këto struktura para arritjes së moshës për pension pleqërie. Ndërkohë, që punësimi i tyre në shërbimet e tjera publike/private është thuajse i pamundur, pasi moshja dhe arsimimi i tyre ndikojnë ndjeshëm në një mundësi të tillë;

- disa punonjës të Policisë së Shtetit dhe të Gardës, për shkak të nevojave të veçanta të punës, si dhe kur ekziston një situatë reale dhe e rrezikshme ndaj jetës dhe familjes së tyre, apo kur për qëllime të zbulimit të krimeve të rënda, infiltrohen në grupe të strukturuar apo organizata kriminale, mund të transferohen jashtë vendbanimit të tyre, gjë që detyron bashkëshortin/en të ndërpresë marrëdhënien e punës. Në këto kushte, me largimin e punonjësit nga puna, familja e tij do të mbetet pa mbështetje ekonomike dhe do të duhet të përballojë jetesën vetëm me pensionin e parakohshëm të tij;
- sikurse është përmendur më sipër, shkalla e vështirësisë në punë të këtyre punonjësve është më e lartë se e punonjësve të institucioneve tjera që janë subjekte të ligjit për trajtime suplementare në vendin tonë, pasi ata përballen çdo ditë me elementë kriminalë, kryejnë veprime policore me rrezikshmëri të lartë për jetën e shëndetin e tyre, si ruajtjen dhe mbrojtjen fizike të personaliteteve të larta shtetërore, ndalime/arrestime, kapje të personave të kërkuar dhe operacione që kërkojnë jo vetëm përgatitje të lartë fizike, por edhe një moshë relativisht të re.

Nevoja e trajtimit financiar dinjitoz të punonjësit të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, buron edhe nga përcaktimet e ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, ligjit nr.8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës”, dhe ligjit nr.70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, ku përcaktohet se të gjithë punonjësve u lind e drejta për trajtim financiar për shkak të ndërprerjes ose pamundësisë së vazhimit të karrierës.

Aktualisht, moshja mesatare e punonjësve të strukturave të sipërpërmendura është mbi 45 vjeç. Me miratimin e këtij projektligji për një periudhë prej 3 vitesh moshja mesatare e punonjësve, kryesisht të policisë, ulet mesatarisht me 2 vite.

Projektligji është një garanci për punonjësit, që janë në marrëdhënie pune dhe një vazhdim logjik i statusit të tyre kur ndërpresin karrierën. Miratimi i këtij projektligji do të ndikojë në cilësinë e punës dhe të performancës së punonjësve në detyrë, në rezultatet në luftën kundër krimit, në treguesit, si dhe në objektivitetin e zbatimit të ligjit, duke synuar që punonjësit të arrijnë të punojnë mbi 30 vjet në këto struktura.

Kjo nismë e re ligjore për të përmirësuar përfitimet aktuale të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, do t'i motivonte ato në përmbushjen me sukses të misionit për rritjen e sigurisë në vend, si dhe do të plotësoheshin rekomandimet e misioneve të huaja në ndihmë të policisë, si PAMECA apo Programi ICITAP,

të cilat kërkojnë rritjen e parametrave aktualë të trajtimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, duke i përafuar ato me standardet e policive të vendeve evropiane.

Nisur sa më sipër, projektligji i paraqitur për miratim është në harmoni të plotë me reformat e ndërmarra dhe prioritetet e përcaktuara nga qeveria.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën, me ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, ligjin nr.8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe me ligjin nr.70/2014, “Për Shërbimet për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”.

Gjithashtu, propozimet e këtij projektligji respektojnë të drejtat e fituara në koherencë me zhvillimet ekonomike të vendit, parimet buxhetore të financimit të shpenzimeve të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, si dhe dispozitat ligjore në fushën e menaxhimit dhe kontrollit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektligji nuk synon përaftrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMbledhje SHpjeguese e PËRMBAJTJES SË PROJEKTQAKTIT

Neni 1 parashikon se qëllimi i këtij projektligji është garantimi i përfitimit të trajtimit financiar të punonjësve të Policisë së Shtetit, të punonjësve të Gardës së Republikës dhe të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, që ndërpresin marrëdhënien e punës, përpara daljes në pension të plotë pleqërie.

Neni 2 parashikon subjektet përfituese të trajtimit financiar, konkretisht, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat me gradë dhe që plotësojnë kriteret sipas këtij ligji.

Neni 3 parashikon se për përfitimin e trajtimit financiar njihet si vjetërsi shërbimi vjetërsia e shërbimit, e përcaktuar në legjislacionin e posaçëm që

rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme.

Neni 4 përcakton kriteret e përfitimit të trajtimit financiar në strukturat e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës së Shqipërisë, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, konkretisht:

- Të kenë plotësuar moshën 55 vjeç dhe të kenë kryer 30 vite shërbim në strukturat e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme apo struktura të tjera shtetërore me gradë. Kjo e fundit për arsye se ka punonjës që kanë ardhur në strukturat e sipërpërmendura nga institucione ushtarake apo institucione të tjera të sigurisë dhe një pjesë të vjetërsisë në punë e kanë në këto struktura.
- Trajtimi financiar është në masën 50% të pagës mujore neto, në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me shërbimin përkatës.
- Trajtimi financiar pas ndërprerjes së karrierës përfitohet me kërkesë të punonjësit, ose kërkesë të titullarit të institucionit përkatës dhe miratohet nga Komisioni i Posaçëm. Përbërja dhe kriteret e vlerësimit të Komisionit të Posaçëm përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5 parashikon se efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji, financohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Brendshme i përcaktuar për trajtimin financiar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme, pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Neni 6 parashikon se trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës indeksohet sa herë që bëhet indeksimi me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7 përcakton detyrimet e punonjësit të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme, që përfitojnë sipas këtij ligji. Subjektet e përfitimit kanë detyrimin t'i përgjigjen nevojave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, për t'u aktivizuar në shërbim në interes të realizimit të misionit të tyre deri në 700 orë në vit.

Mosplotësimi i këtij detyrimi bëhet shkak për ndërprerjen e trajtimit financiar me propozim të titullarit të institucionit përkatës dhe miratim të Komisionit të Posaçëm.

Neni 8 parashikon se dispozitat e këtij ligji zbatohen vetëm për punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme, që pas hyrjes në fuqi të ligjit, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 4 të tij.

Gjithashtu, në këtë nen përcaktohet se trajtimi financiar ndërpritet kur përfituesi rikthehet në shërbim aktiv në strukturën përkatëse, si dhe në rastet kur punësohet në sektorin publik.

Po ashtu, në dispozitat kalimtare është përcaktuar se trajtimi financiar i përfituar nga ky ligj nuk prek përfitimet që i lindin punonjësit të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, nga legjislacioni përkatës në fuqi.

Neni 9 parashikon nxjerrjen akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 10 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit, e cila është përcaktuar në vitin 2020, pasi nuk janë planifikuar fondet e nevojshme për këtë vit buxhetor.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Garda e Republikës dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga strukturat e Ministrisë së Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Numri i punonjësve që aktualisht plotësojnë kriteret për përfitim të trajtimit financiar sipas kriterëve të parashikuara në këtë projektligj është në total **613** punonjës. E ndarë sipas strukturave, si më poshtë:

Nga Policia e Shtetit **585** punonjës, nga këta **398** me gradën “Inspektor”.

Garda e Republikës, **21** punonjës.

Nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministri **7** punonjës.

1-Policia e Shtetit

Nr	Emërtimi	Nr. Puno-njësve	Paga Bruto	Paga Neto	50% e Pg. Neto mujore	Efekti financiar vjetor
1	Drejtues i Parë	5	122,000	91,810	45,905	2,754,300
2	Drejtues	22	118,000	88,598	44,299	11,694,936
3	KryeKomisar	28	106,000	78,962	39,481	13,265,616
4	Komisar	35	91,000	68,328	34,164	14,348,880
5	Nënkomisar	97	84,500	63,726	31,863	37,088,532
6	Inspektor	398	68,500	52,398	26,199	125,126,424
	Shuma	585				204,278,688

2- Garda e Republikës

Nr	Emërtimi	Nr. Puno-njësve	Paga Bruto	Paga Neto	50% e Pg. Neto mujore	Efekti financiar vjetor
1	Kolonel	4	122,111	91,061	45,531	2,185,488
2	N/Kolonel	1	108,623	80,805	40,403	484,836
3	Major	4	93,504	70,101	35,051	1,682,448
4	Kapter mjeshtër	6	58,200	45,106	22,553	1,623,816
5	Kapter shtabi	5	59,250	45,849	22,925	1,375,500
6	Kapter	1	60,400	46,663	23,332	279,984
	Shuma	21				7,632,072

3-SHCBA në Ministrinë e Brendshme

Nr	Emertimi	Nr. Puno-njësve	Paga Bruto	Paga Neto	50% e Pg. Neto mujore	Efekti financiar vjetor
1	Drejtori i përgjithshëm	-	-	-	-	-
2	Zv. Drejtori i përgjithshëm	2	133,739	100,399	50,200	1,204,800
3	Drejtues i parë	-	-	-	-	-
4	Drejtues	2	11,412	84,904	42,452	1,018,848

5	Kryeinspektor	3	102,127	76,206	38,103	1,371,708
6	Inspektor	-	-	-	-	-
	Shuma	7				3,595,356

Tabela përmbledhëse për periudhën 10 vjeçare

Nr	Struktura	Plotësojnë kriteret sipas ligjit										
		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029	Viti 2030
1	Policia e Shtetit	585	43	125	206	224	208	152	163	120	88	107
2	Garda e Republikës	21	4	12	31	20	21	21	8	13	8	18
3	SHÇBA	7	9	10	12	12	13	17	17	14	12	11
	Shuma	613	56	147	249	256	242	190	188	147	108	136

Nga përlogaritjet rezulton se efektet financiare vjetore, nëse zbatohet ligji duke filluar nga viti 2020, për të gjithë punonjësit që plotësojnë kriteret, është 215 506 116 lekë.

Nisur nga mundësitë për zëvendësim, në mënyrë të veçantë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila përfshin numrin më të madh të punonjësve me gradë, sikurse shpjeguar në këtë rubrikë, është vlerësuar që numri i punonjësve që do të përfitojnë trajtimin financiar, të përcaktohet çdo vit në varësi të mundësive për fonde financiare për këtë qëllim.

Sipas kësaj skeme, inspektori do të përfitojë 26 200 lekë në muaj dhe mesatarisht përfshirë edhe gradat e larta rreth 29 297 lekë në muaj.

KËSHILLI I MINISTRAVE